| 31 | 08.04.2024 | Kërkesë për informacion për regjistrim dhe legalizim prone | 09.04.2024 | Përshëndetje, Referuar kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se procedura për regjistrimin e pronës kalon në disa faza. Lutemi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118 në mënyrë që t'jua shpjegojmë hap pas hapi dhe t'ju udhëzojmë në mënyrë praktike. Stafi ynë është i gatshëm t'ju asistojë menjëherë. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 32 | 09.04.2024 | Kërkesë për informacion për shpallje martese midis dy shtetasve shqiptarë | 09.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion , Ju bëjmë me dije se: Procedura për të bërë **shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë** është si më poshtë vijon: Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Nuk ka rëndësi se në cilën minibashki apo | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | komunë fillon procedura. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të jenë të dy bashkë.<br>Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë:<br>• fotokopje e dokumentit të identifikimit brenda afatit të vlefshmërisë ( Kartat e identitetit me vete të dy partnerët)<br>Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë kalendarike nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, janë të lirë të vazhdojnë me procedurat e lidhjes së martesës.<br>Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit! | | |
| 33 | 09.04.2024 | Kërkesë për informacion për hartim i planit të rilevimit | 09.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se plani i rilevimit cituar në shkresën e ASHK, hartohet pranë një topografi të licensuar. Ju mund të drejtoheni ASHK-së edhe nëpërmjet shërbimit "Hartim i planit të rilevimit", nga llogaria juaj në e-albania, por do t`ju marrë më shumë kohë, pasi specialistët e ASHK-së duhet të dalin në terren për të hartuar planin. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13877 Kostoja e këtij shërbimi është 5000 (pesë mijë) lekë. Po kaq është dhe detyrimi që merr topografi i licensuar privat për cdo plan rilevimi, por e merrni shërbimin shumë më shpejt. Pë t`u orientuar më shumë mund të paraqiteni edhe tek sektori i urbanistikës në bashkinë apo minibashkinë Tuaj. Ne ua informuam të dy opsionet. Zgjedhja është Juaja. Për çdo pyetje e paqartësi na telefononi në numrin pa pagesë 0800 01180nga e hëna në të premte nga ora 080.00 deri në orën 19.00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 34 | 09.04.2024 | Kërkesë për informacion për pajisje me kartë identiteti | 09.04.2024 | Përshëndetje, Lutemi drejtohuni chatit online në faqen zyrtare të institucionit https://www.adisa.gov.al/ me qëllim që t'ju sqarojmë imtësisht për procedurën për pajisje me kartë identiteti. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 35 | 11.04.2024 | Kërkesë për informacion për certificate nga akti i martesës | 11.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se Certifikata nga akti i martesës" për martesa të lidhura për periudhën 1923 - 2010, lëshohet *brenda 3 (tre) ditëve pune*. Nëse shërbimi nuk është lëvruar në këtë afat ligjor, lutem depozitoni ankesën Tuaj në portalin e bashkëqeverisjes, ose plotësoni të dhënat në formularin e ankesës bashkëlidhur këtij email-I Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 36 | 11.04.2024 | Kërkesë për informacion për passaportë biometrike | 11.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se: Afati më i shkurtër për tù pajisur me pasaportë biometrike është brenda 72 orëve. Ky shërbim realizohet duke paguar kuponin emergjent prej 18 mijë lekësh. Me kupon 7500 lekësh, afati i pajisjes me pasaportë është 14 ditë. Në rastin e aplikimit me procedurë të përshpejtuar, duhet të ngarkoni në aplikim përveç fotos në format dokument 4x5, edhe foton e kuponit emergjent 18 mijë lekësh. Lidhur me pyetjen nëse mund të ndërroni kuponin 7500 lekësh në kupon 18 000 lekësh, bëjmë me dije se kjo mbetet kompetencë e sportelit ku keni blerë kupunin e mëparshëm.Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 37 | 11.04.2024 | Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi | 11.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të vepronі si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. **Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri.** Faleminderit. | | |
| 38 | 11.04.2024 | Kërkesë për informacion për lëshim kopje kartele pasurie | 11.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se dokumenti që u citohet dhe kërkohet nga ASHK në shkresën e saj është: Leje për sheshin e ndërtimit (formulari nr. 2) Lista emërore e pronarëve të trojeve dhe shtëpive", që shërben për regjistrimin e pasurisë. Këto dokumente i duhen ASHK-së në mënyrë që të procedojë me korrigjimet e kërkuara nga ana juaj.Për çdo pyetje apo paqartesi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte, në fashën orare 08.00 – 19.00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 39 | 11.04.2024 | Kërkesë për informacion për certifikatë familjare para vitit 2010 | 11.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se gjatë ditës së sotme ka patur probleme me sistemin online. Lutemi provoni përsëri në një moment të dytë. Për çdo pyetje apo paqartesi tjetër, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte, në fashën orare 08.00 – 19.00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 40 | 11.04.2024 | Kërkesë për informacion për leje ndërtimi | 12.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se për të rikonstruktuar shtëpinë tuaj, ju duhet të aplikoni në portalin e-albania për leje ndërtimi. Bashkëlidhur linku i aplikimit: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6093 Kini paraqysh që ju duhet të zgjidhni llojin e lejes për të cilën po aplikoni në bazë të ndërtimit që doni të bëni. Lutemi lexoni me kujdes formatet e lejeve që ju vjen në ndihmë dhe më pas ndiqni hapat e procedurës. Për çdo pyetje apo paqartesi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në të premte, në fashën orare 08.00 – 19.00. Ne jemi të gatshëm t'ju ndihmojmë me procedurat e aplikimit! Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 41 | 12.04.2024 | Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi | 12.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 42 | 12.04.2024 | Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi | 12.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 43 | 12.04.2024 | Kërkesë për informacion për rivlerësim pasurie | 12.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë pasur të drejtë deri në datën 30 prill 2022 të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me 3% për të sjellë pronën e tyre në vlerën e tregut. Nga 30 prill 2022, nuk ka vendim për periudhë tjetër rivlerësimi. Lidhur me pyetjen Tuaj se si behet rivlerësimi i pasurisë dhe sa është çmimi që duhet paguar gjithmonë në rast se | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | do bëni veprime me pronën ( shitje, dhurim) tatimi që paguani është i barabartë me: 15% e diferencës së shitjes së pronës me çmimin e blerjes, apo regjistrimit të pronës në hipotekë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 44 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për Pension shtetëror suplementar i personave me funksione kushtetuese | 15.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nuk është i nevojshëm as shkarkimi i kartelës informative, as paraqitja në qëndrat ADISA, pasi sportelet nuk funksionojnë që nga 1 Maj 2022.Për të realizuar aplikimin lidhur me kartelën informative me kod AL112082, duhet të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, "Pension shtetëror suplementar i personave me funksione kushtetuese", në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=6171*Për këtë shërbim nuk nevojitet dokumentacion shoqërues.* Për çdo paqartësi apo asistencë, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118, ose online chat në faqen zyrtare adisa.gov.al, nga e hëna në të premte në fashën orare 08.00-19.00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 45 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për çrregjistrim i personit të vdekur | 15.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse personi ka ndërruar jetë dhe është bërë çrregjistrimi nga regjistri kombëtar i popullsisë, automatikisht është mbyllur dhe llogaria me të dhënat e Tij në e-albania. Për çdo informacion, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0118 ose online chat, nga e hëna në të premte nga ora 08.00 deri në orën 19.00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 46 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi | 15.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të vepronі si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Faleminderit | | |
| 47 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për gjenerim passwordi | 15.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se, nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 48 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për regjistrim të subjektit tatimpagues | 15.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion Ju bëjmë me dije se pë të hapur NIPT fermeri duhet të pajiseni me një numër personal tek Drejtoria e Buqësisë në rrethin Tuaj dhe më pas të aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin, Kërkesë për regjistrimin e një subjekti tatimpagues, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13938 Për cdo pyetje ose paqartësi na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 ose në kanalin e komunikimit (online chat); nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 49 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për gjenerim password | 15.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri.Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 50 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për gjenerim password | 15.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se nëse nuk arrini të logoheni (futeni) në llogarinë Tuaj në e-albania, nëse nuk i keni aktive të dhënat e regjistrimit (adresë email apo numër telefoni) apo kur nuk mbani mend fjalekalimin, për të gjeneruar një pasword të ri duhet të veproni si më poshtë: Dërgoni email në adresën: helpdesk@e-albania.al : Bashkëlidhur edhe të dhënat e mëposhtme: - foto të kartës ID - emri i nënës - emri i babait - vendlindja e nënës. Specifikoni adresën email dhe numrin e telefonit që doni të përdorni në vazhdim për llogarinë tuaj në portal. Brenda 5( pesë) ditëve adresa ku keni dërguar email-in do t`Ju pajisë me një kod katërshifror me anë të të cilit zhbllokohet llogaria dhe u jep të drejtën të vendosni një fjalëkalim të ri. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 51 | 12.04.2024 | Kërkesë për informacion për passaportë dhe kartë identiteti për shtetasit që jetojnë jashtë kufijve shqiptarë | 15.04.2024 | Përshëndetje, Ju bëjmë me dije se aplikimi për passaportë dhe kartë Identiteti për shtetasit që jetojnë jashtë kufijve shqiptarë kërkon 10 ditë pune. Më pas ju do të njoftoheni në email për procedurat e pagesës dhe pasi të keni kryer pagesat dhe të keni caktuar ditën e takimit, Ju duhet të paraqiteni pranë Konsullatës në shtetin grek për të vijuar me procedurat e kryerjes së passaportës. Për pyetje të | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | tjera lutemi na u drejtoni në livechat online në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/ . Faleminderit! | | |
| 52 | 12.04.2024 | Kërkesë për informacion për provim shteti | 15.04.2024 | Përshëndetje, Lutem depozitoni ankesën Tuaj në portalin e bashkëqeverisjes, ose plotësoni të dhënat në formularin e ankesës bashkëlidhur këtij email-i: https://www.shqiperiaqeduam.al/ Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 53 | 13.04.2024 | Kërkesë e paplotë për informacion | 15.04.2024 | Përshëndetje, Lutemi na kontaktoni në numrin jeshil pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 që të mund t'ju udhëzojmë për rastin tuaj, pasi kërkesa juaj për informacion është e paplotë. Kështu mund të zhvillojmë dialog dhe të na tregoni rreth aplikimit dhe dokumentacionit që kërkoni të ngarkoni. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 54 | 14.04.2024 | Kërkesë për informacion për shpallje martese midis dy shtetasve shqiptarë | 15.04.2024 | Përshëndetje, Procedura për të bërë **shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë** është si më poshtë vijon: Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Nuk ka rëndësi se në cilën minibashki apo komunë fillon procedura. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të jenë të dy bashkë. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: fotokopje e dokumentit të identifikimit brenda afatit të vlefshmërisë ( Kartat e identitetit me vete të dy partnerët). Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë kalendarike nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, janë të lirë të vazhdojnë me procedurat e lidhjes së martesës. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit! | | |
| 55 | 14.04.2024 | Kërkesë për informacion për shpallje martese midis dy shtetasve shqiptarë | 15.04.2024 | Përshëndetje, Procedura për të bërë **shpalljen e martesës mes dy shtetasve shqiptar në Republikën e Shqipërisë** është si më poshtë vijon: Shpallja e martesës bëhet nga të dy bashkëshortët e ardhshëm në zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative ku kanë vendbanimin. Nuk ka rëndësi se në cilën minibashki apo komunë fillon procedura. Gjatë shpalljes së martesës bashkëshortët e ardhshëm do të jenë të dy bashkë. Dokumentet e nevojshëm për shpalljen e martesës janë: fotokopje e dokumentit të identifikimit brenda afatit të vlefshmërisë ( Kartat e identitetit me vete të dy partnerët). Martesa nuk mund të lidhet para se të kalojnë 10 ditë kalendarike nga e nesërmja e shpalljes. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, janë të lirë të vazhdojnë me procedurat e lidhjes së martesës. Për cdo pyetje apo paqartësi na kontaktoni në kanalin informativ pa pagesë 0800 0118, ose online chat, nga e hëna në te premte ne fashen orare 08.00 – 19.00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 56 | 15.04.2024 | Kërkesë e paplotë për informacion | 16.04.2024 | Përshëndetje, Lutemi dërgoni kërkesën e plotë për informacion. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 57 | 16.04.2024 | Kërkesë për informacion për aplikim për informacion zyrtar të pasurisë | 16.04.2024 | Përshëndetje, **Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për statusin e legalizimit aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin:** Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e meposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477Fi llimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti në lidhje me dosjen në proces | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | legalizimi . Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF . Kërkesa do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania. **Për të përdorur shërbimin, klikoni "Përdor" në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik. Në hapin e dytë, tek të dhënat e pronës, pamvarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet objekti Juaj. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit.** Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në poste për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me poste të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni. **Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni.** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 58 | 16.04.2024 | Kërkesë për informacion për aplikim për informacion zyrtar të pasurisë | 16.04.2024 | Përshëndetje, **Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për statusin e legalizimit aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin:** Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e meposhtem: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477Fi llimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti në lidhje me dosjen në proces legalizimi . Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF . Kërkesa do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania. **Për të përdorur shërbimin, klikoni "Përdor" në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik. Në hapin e dytë, tek të dhënat e pronës, pamvarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone,** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet objekti Juaj. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit.** Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në poste për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me poste të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni. **Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni.** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 59 | 16.04.2024 | Kërkesë për informacion për taksat dhe tarifat vendore | 16.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, po ju vendosim në dispozicion linkun e aplikimit për taksat dhe tarifat vendore: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=36. Në se ky shërbim nuk plotëson kërkesat tuaja, lutemi na telefoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00 që të na sqaroni cfarë ekzaktësisht kërkoni dhe t'ju orjentojmë direkt nga telefoni. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 60 | 15.04.2024 | Kërkesë për informacion për korrigjim të dhënash personale në regjistrin elektronik | 16.04.2024 | Përshëndetje, Nëse ju keni një dokument të mëparshëm me emrin tuaj origjinal, dërgoni email në helpdesk@e-albania.al bashkëlidhni edhe foton e dokumentit të vjetër dhe prisni përgjigjen. Nëse e keni edhe në dokumentin e vjetër emrin Zerea dhe e keni po kështu në aktin e lindjes atëhere nuk keni çfarë të bëni. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 61 | 16.04.2024 | Kërkesë për informacion për lëshim kopje kartele e pasurisë | 17.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju mund të aplikoni online në portalin e-albania në shërbimin: Aplikim për lëshim kopje kartele të pasurisë: **https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9461** | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Hapat e procedurës**<br>- Identifikohuni si qytetar ose si biznes në portal;<br>- Zgjidhni shërbimin "Aplikim për lëshim kopje kartele të pasurisë";<br>- Klikoni butonin "Përdor";<br>- Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi pronën, shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme;<br>- Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit;<br>- Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën ose kryeni pagesën online përmes portalit e-Albania me një kartë debiti ose krediti;<br>- Punonjësi i ASHK-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret i kthen përgjigje aplikuesit, që mund të gjendet tek "Dokumentet e mia" në portalin e-Albania.<br>*** Njoftim:** Pas kryerjes së aplikimit ju nuk duhet të prisni shërbimin postar për kthim-përgjigjen e aplikimit të kryer, por do të mund të merrni përgjigjen me vulë dhe firmë elektronike tek "Dokumentat e Mia" në profilin tuaj në e-Albania. **Aplikimin e kryer ne e-albania së bashku me faturën e bankës përvec aplikimit online duhet ta nisni me postë pranë ASHK.** **Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit**. Nëse pasuria është e dixhitalizuar pas konfirmimit të kryerjes së pagesës kopja e kartelës do ju shfaqet tek *Dokumentet e mia*, nëse jo pas konfirmimit të kryerjes së pagesës kopja e kartelës do të digjitalizohet dhe me pas do ju shfaqet tek *Dokumentet e mia* brenda 5 ditë pune. **Periudha e vlefshmërisë** Pa afat<br>**Kostot** 1000 lekë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 62 | 18.04.2024 | Kërkesë për informacion për mundësi punësimi | 18.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të parë vendet vakante në Adisa duhet te vizitoni linkun e mëposhtëm: https://www.adisa.gov.al/mundesi-punesimi/ Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 63 | 18.04.2024 | Kërkesë për informacion për Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë | 18.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjmë me dije se për të marrë informacion për çështjen që referoni në kërkesën për informacion, së pari duhet të paraqiteni pranë Komunës Tuaj të pajiseni me listën e familjes bujqësore, e më pas aplikoni nga llogaria Juaj në e-albania shërbimin: **Aplikim për informacion zyrtar të pasurisë për individët dhe personat juridikë (privatë dhe publikë), ne linkun e meposhtem:**https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9477 **Fillimisht duhet të hartoni një kërkesë me shkrim, ku të sqaroni arsyet e përdorimit të këtij dokumenti duke specifikuar qe u duhet kopje AMTP. Kjo kërkesë duhet të firmoset nga ana Juaj dhe të skanohet në formatin PDF . Kërkesa do të ngarkohet në hapin e tretë të aplikimit të shërbimit në e-Albania.** Për të përdorur shërbimin, klikoni “Përdor” në fund të faqes dhe vijoni me plotësimin e formularit elekronik. Në hapin e dytë, tek të dhënat e pronës, pamvarësisht se Ju nuk keni të dhëna prone, për të orientuar sistemin duhet të vendosni një zonë të saktë kadastrale, ndërsa volumin dhe faqen i vendosni 99. Zona kadastrale duhet të jetë zona që përfshin zonën ku ndodhet objekti Juaj. Klikoni butonin “Dërgo” në faqen e fundit të formularit. Shkarkoni mandatpagesën me të cilën mund të paraqiteni në bankë ose në poste për të kryer pagesën, si dhe depozitimin me poste të kërkesës që keni bashkëlidhur aplikimit dhe mandatin e pagesës që do të kryeni. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do T`Ju pajisë me informacionin që kërkoni.Për cdo pyetje ose paqartësi, na | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 64 | 18.04.2024 | Kërkesë për informacion për Vërtetim për aplikim për legalizim ndërtimi informal | 19.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se për t'u pajisur me vërtetimin që kërkoni, ju duhet të aplikoni online në portalin e-albania në shërbimin: Vërtetim për aplikim për legalizim ndërtimi informal: **https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12411** **Dokumentacioni i nevojshëm** *Dokumente që ngarkohen nga aplikanti:* - Kopje e vetëdeklarimit të objektit. **Hapat e procedurës** - Identifikohuni si qytetar në portalin e-Albania. - Zgjidhni shërbimin "Vërtetim për aplikim për legalizim ndërtimi informal". - Klikoni butonin" Përdor". - Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara në formular. - Klikoni butonin “Dërgo” në fund të formularit. - Punonjësi i ASHK-së njoftohet elektronikisht për mbërritjen e një aplikimi të ri dhe verifikon saktësinë e dokumenteve e nëse janë të plota. - Nëse ka pasaktësi ose mungesë dokumentesh, punonjësi i ASHK-së njofton aplikantin për pasaktësitë dhe e udhëzon për të riplotësuar praktikën e aplikimit. - Vërtetimi i dërgohet aplikantit në mënyrë elektronike me e-mail tek "Hapësira ime", në seksionin "Dokumentet e mia". **Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit** 10 ditë **Periudha e vlefshmërisë** Pa afat **Kostot** 300 lekë. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose na kontaktoni në live chat në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 65 | 19.04.2024 | Kërkesë për informacion për rinovim pasaporte për fëmijën | 19.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion ,Ju bëjmë me dije se për të kryer aplikimin për pajisje te femijes për herë të parë me pasaportë, duhet te aplikoni nga llogaria e prindit në e-albania shërbimin: Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës, në linkun e mëposhtëm: https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=13851. Klikoni opsionin “Përdor” dhe plotësoni formularin “Aplikim i formularit për lëshim për herë të parë ose rinovim të pasaportës”. | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Zgjidhni opsionin "Për fëmijën" dhe vazhdoni me plotësimin e të dhënave që u kërkohen. **Ju nevojitet ngarkimi i fotografisë së fëmijës në standardin 4x5cm në formatin jpg, jpeg ose png. Në rastin kur aplikimi është me procedurë të përshpejtuar (ose aplikim emergjent), nevojitet përveç ngarkimit të fotos, edhe ngarkimi i kopjes së kuponit të procedurës së përshpejtuar.** Pas shqyrtimit të aplikimit do të njoftoheni me sms dhe e-mail për miratimin ose jo të procedurës ligjore të kërkuar nga Policia.<br>Ditën që do të paraqiteni fizikisht për të vijuar me aplikimin, duhet të keni me vete kuponin dhe fëmijën. Nëse fëmija ka pasur pasaportë 5 - vjeçare dhe i ka mbaruar vlefshmëria, mjafton të bleni kuponin në postë dhe të rezervoni takimin tek Aleat. Nuk nevojitet aplikimi i formularit të policisë në e-albania. **Kujdes!** Emaili me të cilin jeni i regjistruar në e-albania duhet të jetë aktiv sepse atje do Ju vijë miratimi i aplikimit Tuaj dhe linku për rezervim. **Lidhur me pyetjen se ku janë zyrat e Identitek, bëjmë me dije se zyrat ndodhen afër gjendjes Tuaj civile. Ndërsa për oraret, nuk ka nevojë për rezervim**. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 66 | 18.04.2024 | Kërkesë për informacion për regjistrim të aktit të martesës | 19.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës Tuaj për informacion, Ju bëjme me dije se dokumenti i vetëm që duhet për të regjistruar martesën në gjendjen civile në Shqipëri, është Akti i martesës me vulë apostile.<br>Mënyra tjetër e regjistrimit të aktit të martesës është edhe online nga llogaria Juaj në e-albania nëpërmjet shërbimeve konsullore. Aplikim për regjistrim martese. https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=9768<br>*Dokumentet që duhet të ngarkohen nga aplikanti:*<br>- Certifikata e martesës, lëshuar nga autoritetet e huaja (e legalizuar ose pajisur me vulë apostile) - Përkthimi i certifikatës së martesës, i legalizuar ose pajisur me vulë apostile (nëse nuk e legalizoni apo apostiloni përkthimin e certifikatës, kërkohet që | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | përkthimi në gjuhën shqipe të kryehet në konsullatë ose nëse është kryer përkthimi nga përkthyes të licensuar, duhet që konsulli të lëshojë "vërtetim përkthimi". (Tarifa e përkthimit apo vërtetimit të përkthimit është 10 euro për faqe dhe është detyrim i qytetarit aplikues) - Dokumente identifikimi, pasaportë e vlefshme udhëtimi ose letër njoftimi e bashkëshortëve. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | | |
| 67 | 19.04.2024 | Kërkesë për informacion për kredi për banesë sociale | 19.04.2024 | Përshëndetje, Ne jemi qendër informimi për shërbimet publike në portalin e-albania. Lutemi kontaktoni në bashki për t'ju ndihmuar me aplikimin dhe procedurat. Faleminderit. | E plotë | Nuk ka |
| 68 | 19.04.2024 | Kërkesë për informacion për njehsim diplome nga IAL | 24.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se afati për marrjen e shërbimit të njehsimit të diplomës është 45 ditë pune. Nëse shërbimi nuk është lëvruar në këtë afat ligjor, lutem depozitoni ankesën Tuaj në portalin e bashkëqeverisjes në adresën zyrtare https://www.shqiperiaqeduam.al/. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 69 | 19.04.2024 | Kërkesë për informacion për lidhje martese me shtetas të huaj | 24.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se, në rastin e lidhjes së martesës me një shtetas të huaj, nga bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi i huaj) paraqiten dokumentet e mëposhtme për shpalljen e martesës (të legalizuar, përkthyer dhe noterizuar):<br><br>• Certifikatë lindje, e plotësuar me të gjithë përbërësit e Gjendjes Civile, që pasqyrohen në rubrikat e Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile;<br>• Dokumentin / Certifikatë që vërteton se nuk ka pengesë ligjore në vendin e tij për lidhje martese (vërtetim për leje lidhje martese); | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Dokument ku vërtetohen të dhënat e vendbanimit në shtetin e huaj;<br>• Fotokopje e dokumentit të identifikimit.<br><br>Këto dokumenta duhet të jenë me vulë APOSTILE ose të legalizuar nga përfaqësitë tona diplomatike jashtë vendit. Dokumentacioni duhet të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar. Shpallja e martesës kryhet në Bashki / Njësi Administrative, ku ka vendbanimin bashkëshorti i ardhshëm (shtetasi shqiptar). Pas kalimit të afatit 10 ditor nga e nesërmja e shpalljes, shtetasi shqiptar që do të lidhë martesë pajiset me dokumentacionin e mëposhtëm:<br><br>• Certifikatë lindje;<br>• Certifikatë lindje me shënimin "për lidhje martese".<br><br>Dokumentet duhet të legalizohen në institucionin e Prefekturës dhe në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe më pas bashkëshortët e ardhshëm ndjekin procedurën sipas legjislacionit të vendit ku do të lidhet martesa. Aplikimet për legalizimin e dokumenteve kryhen nëpërmjet Postës Shqiptare. Pas lidhjes së martesës në shtetin e huaj, dokumenti i martesës (certifikatë martese /ekstrakt akt martese) i legalizuar, përcillet për regjistrim në shërbimin e Gjendjes Civile në Shqipëri, në zyrën e Gjendjes Civile, ku bashkëshorti shqiptar ka vendbanimin. Afati i vlefshmërisë për lidhjen e martesës së shpallur është 1 vit. Referuar pyetjes tuaj, dokumentacionin duhet ta merrni nga institucionet gjermane dhe të apostilohet pranë zyrave të ambasadës që të jetë i vlefshëm. Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose në livechat online në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/.  Faleminderit! | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 70 | 19.04.2024 | Kërkesë për informacion për transferim dosje pensioni | 24.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion, ju bëjmë me dije se ju duhet të kryeni aplikimin e saktë. Aplikoni edhe njëherë tek shërbimi "**Kërkesë për transferim dosjeje përfitimi (pensioni)" dhe vendosni kredencialet dhe të dhënat e sakta!** Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në numrin pa pagesë 0800 0 118, nga e Hëna në të Premte, nga ora 08:00 deri në 19:00, ose në livechat online në faqen tonë zyrtare https://www.adisa.gov.al/. Faleminderit! | E plotë | Nuk ka |
| 71 | 21.04.2024 | Kërkesë për informacion për passaportë biometrike | 24.04.2024 | Përshëndetje, Në vijim të kërkesës tuaj për informacion ju bëjmë me dije se në rastin tuaj, ju duhet të deklaroni humbjen e dokumentit pranë policisë në vendin ku jetoni. Më pas duhet të aplikoni online në e-albania për shërbimin "**Aplikim për pasaportë dhe kartë identiteti (për shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë kufijve)**" **Hapat e procedurës** - Identifikohuni në portalin e-Albania - Zgjidhni shërbimin "Aplikim për pasaportë dhe kartë identiteti" - Klikoni butonin "Përdor" - Zgjidhni nëse do të kryeni një aplikim të ri apo do të gjurmoni statusin e një aplikimi ekzistues - Për të gjurmuar statusin e një aplikimi ekzistues, vendosni numrin e aplikimit dhe më pas klikoni butonin "Kërko" - Për të kryer një aplikim të ri, klikoni butonin "Krijo aplikim të ri", plotësoni të dhënat në formularin elektronik dhe ngarkoni dokumentet që janë të domosdoshme për verifikim. Me anë të e-mail-it të plotësuar në rubrikën përkatëse, do t'ju dërgohet konfirmimi i aplikimit si dhe kodi i veçantë i aplikimit (i cili mundëson ndjekjen e ecurisë së aplikimit në çdo moment) *Kujdes: E-maili mund tju vijë në spam/junk. Kontrolloni të gjitha rubrikat e emailit tuaj pas aplikimit.* - Ndiqni procedurat për të kryer pagesën dhe për të pasur me vete mandat pagesen ditën që do të paraqiteni në Ambasadë/Konsullatë - Paraqituni në përfaqësi për të lënë shenjat e gishtërinjve dhe firmosur ( e detyrueshme). **Koha e nevojshme e marrjes së shërbimit** 10 ditë. *Nëse ka parregullsi në dokumentacion, koha e marrjes së shërbimit zgjat maksimalisht 30 ditë.* Për cdo pyetje ose paqartësi, na kontaktoni në | E plotë | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | livechat online në faqen tone zyrtare https://www.adisa.gov.al/.  Faleminderit! | | |
